



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1096

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Isa Hasani, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “INFINITT” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KOMUNA E GJAKOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi, montimi dhe servisimi i kondicionerëve në shkollë” me numër të prokurimit; 632-25-6413-1-2-1, me 16/12/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “INFINITT” SH.P.K. me nr. 2025/1096, e datës 06/11/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi, montimi dhe servisimi i kondicionerëve në shkollë” me numër të prokurimit; 632-25-6413-1-2-1. inicuar nga autoriteti kontraktues – Komuna Gjakovë.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – Komuna Gjakovë, datës, 10.10.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1 (një) të vendimit.
3. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik OE “INFINITT” SH.P.K. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për siguri të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 16.07.2025, Komuna Gjakovë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar, Njoftimin për kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, montimi dhe servisimi i kondicionerëve në shkollë” me nr. të prokurimit: 632-25-6413-1-2-1. ndersa me datën 1-10.2025 ka nxjerr, Njoftimin mbi vendimin e AK-së për dhenie. OE “ASTECH SH.P.K.”-

Prishtinë

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 51,420.00 €.

Me 20.10.2025, "INFINITT" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 27.10.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06.11.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "INFINITT" SH.P.K me nr. 2025/1096 për lidhur me aktivitetin "Furnizimi, montimi dhe servisimi i kondicionerëve në shkolla" me nr. të prokurimit 632-25-6413-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "INFINITT" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 10.09. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate OE As Tech SH.P.K. Kompania jone eshte eliminuar me arsyetimin se ne deklaraten per themelimin e grupit mungon nenshkrimi dhe vula te perfaqesuesi i autorizuar. Me 11.09. kemi derguar kerkese per qasje ne dokumente zyrtare dhe me 12.09. AK na ka ofruar qasjen sipas kerkeses sone.

Nga dokumentet te cilat i kemi pranuar ne qasjen ne dokumente zyrtare konstatojme se AK ka rekomanduar per kontrate OE i cili rezuton te jete i papergjegjshem per arsyetjet si ne vijim: Kerkese ne 4 lidhur me kapacitetin teknik&profesional ne nenin 9.1&9.2 te FDT-se ka qene qe te dorezohen deshmi:

OE As Tech shpk ka dorezuar katalogun vetem per pozicionet 1-4 ne specifikacion, mungon katalogu dhe specifikimet teknike per pozicionet 6,7,8,9,10,11,12,13,14,20,26 ne kete menyre OE eshte i papergjegjshem pasi qe nuk ka dorezuar katalogun sipas kerkeses se AK ne FDT, citoj: Katalog apo broshure me fotografi per produktet e ofruara. AK ne dosjen e tenderit ka kerkuar katalog per te gjitha produktet jo vetem per pozicionet 1-4.

Sipas nenit 10.1 te UOPP i hyre ne fuqi me 15.12.2025. ne kete suate parashihet qe te refuzohet tenderi pa kerkuar informacione shtese, citoj: Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu/ Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Neni 28 i LPP-se.

OE i rekomanduar per kontrate poashtu eshte i papergjegjshem pasiqe nuk ka dorezuar katalog autentik nga prodhuesi, citoj kerkesen ne FDT OPERATORI EKONOMIK DUHET TE OFROJE KATALOG APO BROSHURE ME FOTOGRAFI NGA PRODHUESI, OE i rekomanduar per kontrate ka dorezuar nje katalog te pergaditur nga vete OE ku nuk eshte cekur prodhuesi brendi si dhe nuk dihet autenticiteti i katalogut te cilin ka dorezuar OE ne kete menyre eshte dashur te eliminohet si i papergjegjshem.

Komisioni vleresues nuk eshte dashur te mere si te mireqene katalogun e dorezuar nga OE Astech sh.p.k. pasiqe nuk i ka te dhenat bazike emrin e prodhuesit dhe modelin katalogu nuk eshte i leshuar nga prodhuesi. OE ka vene ne lajthitje komisionin pasiqe ka pergaditur nje file me te dhenat teknike te cilat nuk mund te verifikohen a jane autentike dhe nuk dihet cilit model-klime i takojne.

AK/Zyra e prokurimit ka favorizuar OE ne fjale duke kerkuar sqarime shtese nga OE te gjitha deshmite lidhur me stafin sipas kerkesave qe nderlidhen me kapacitetin teknik&profesional ne FDT ne kete menyre me kembengulje AK tenton ta nxjere te pergjegjshem OE me cmimin me te larte te ofertuar ne kete aktivitet te prokurimit sikur te ishte oferta me e lire, sipas nenit 1 Qellimi i ketij ligji eshte qe te shfrytezohen fondet ne menyre sa me racionale e ekonomike e jo te veprohet ne kete forme OE me cmim dukshem me te lire 9250.00 euro apo 25% me te ulet te elemimohet per detaje te vogla ndersa OE me cmimin me te larte favorizohet duke iu kerkuar sqarime shtese dy here dhe duke iu mundesuar qe me shume dokumente te dergohen si sqarime shtese se ato qe i ka bashkangjitur OE ne ofertim. Konstatimi i AK se nuk kemi percaktuar ne mareveshjen e konzorciumit perfaqesuesin e autorizuar nuk qendron, ne piken 3 ne faqen 2 te mareveshjes Anetaret e grupit deklarojne, citoj;

3. Ne të gjithë anëtarët e grupit e autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe ai është: INFINITT SH.P.K.

Mareveshja eshte e nenshkruar&vulosur nga te dy palet dhe poteson te gjitha kushtet konform kerkesave ligjore te percaktuara ne nenin 11.1 te FDT-se.

Pretendime ankimore pas NJVAK 2 ne ri-vleresim te publikuar me 13.10.

AK/komisioni vleresues ka vazhduar me te njejtat shkelje ligjore edhe ne ri-vleresimin e ofertav. Me 13.10. eshte nxjere njoftimi mbi vendimin e AK pas ri-vleresimit te ofertave ku eshte rekomanduar per kontrate OE i njejte i cili ishte rekomanduar per kontrate dhe ne vleresimin e pare.

Me 15.10. kemi derguar kerkese per qasje ne dokumente zyrtare dhe AK me 16.10. na ka ofruar qasje sipas kerkeses sone.

Nga dokumentet te cilat i kemi pranuar ne qasjen ne dokumente zyrtare konstatojme se AK/komisioni vleresues edhe ne ri-vleresim ka rekomanuar per kontrate OE te papergjegjshem per arsyejet e njejta.

OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem pasiqe nuk ka dorezuar katalog autentik nga prodhuesi, citoj kerkesen ne FDT OPERATORI EKONOMIK DUHET TE OFROJE KATALOG APO BROSHURE ME FOTOGRAFI NGA PRODHUESI, OE i rekomanduar per kontrate ka dorezuar nje katalog te pergaditur nga vete OE ku nuk eshte cekur prodhuesi brendi si dhe nuk dihet autenticiteti i katalogut te cilin ka dorezuar OE ne kete menyre eshte dashur te

eliminohet si i papergjegjshem. AK/zyra e prokurimit me 03.10. pas kthimit te lendes ne ri-vleresim i eshte drejtuar OE me leter standarde per sqarime shtese duke kerkuar:

Katalog ose broshure me fotografi nga prodhuesi, sipas specifikave te dosjes se tenderit

Deshmia: Katalogu apo broshura me fotografi per produktet e ofertuara se bashku me nje pershkrim te karakteristikave te produkteve.

Komisioni ri-vleresues nuk eshte dashur te mere si te mireqene katalogun e dorezuar nga OE Astech sh.p.k. pasi nuk i ka te dhenat bazike emrin e prodhuesit dhe modelin katalogu nuk eshte i leshuar nga prodhuesi. OE ka vene ne lajthitje komisionin pasi ka pergaditur nje file me te dhenat teknike te cilat nuk mund te verifikohen a jane autentike dhe nuk dihet cilit model-klime i takojne., poashtu ne katalog nuk paraqiten te dhenat Auto-defrost dhe Led display, prandaj eshte e palogjikshme se si komisioni ka vleresuar te rekomandoje per kontrate kete operator te papergjegjshem i cili nuk dihet qfare modeli te klimave ka ofertuar. Ne kete menyre AK haptas ka favorizuar OE ne fjale duke i lene mundesin e hapur qe ne ofertim te dorezoje/liferoje qfare do modeli te klimave pasi OE nuk ka cekur brendin ne ofertim (katalog) dhe nuk dihet qfare marke te klimave ka ofertuar.

AK/komisioni i ri-vleresimit ka vepruar jashteligjshem kur i eshte drejtuar me leter standarde per sqarime shtese OE Astech shpk megjithese kjo shtate nuk parashihet me dispozitat ligjore te nenit 59, 72 te LPP-se dhe nenit 10.1 te UOPP-se. OE nuk ka dorezuar specifikimet teknike prandaj ne kete shtate nuk parashihet te kerkohet katalogu pasi paraqet ndryshim material dhe nuk mund te konstatohet ne menyre objektive ekzistenca e ketij katalogu para dorezimit te ofertave. LPP dhe UOPP parasheh sqarim/plotesim e jo ndryshim material, citoj nenin 59.2 te LPP-se:

3. Autoriteti kontraktues mundet qe me shkrim te kerkojne nga nje tenderues qe te siguroje nje sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit te tij, ne menyre qe te behet ekzaminimi, vleresimi ose krahasimi i tenderëve. Asnje ndryshim material dhe asnje aspekt i tenderit nuk duhet te kerkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose te ofrohen nga nje tenderues.

Poashtu ne katalogun e dorezuar per paisjet tjera OE nuk ka ofruar specifikim teknik te ofruar por vetem pershkrimin e dosjes se tenderit i ka bashkangjitur foto te produkteve te nxjera nga interneti nder te tjera te njejten foto kinse katalog te produktit ka prezentuar tek pozicioni 12 Pllaka elektronike dhe pozicioni 20. Tabela komanduese megjithese keto jane 2 produkte te ndryshme.

Megjithese nuk ka qene pretendim ankimor ne ankesen e dorezuar me 15.09. ne pas qasjes ne dokumente zyrtare pas NJVAK 2 kemi veretjur dhe AK duhet te shqyrtoj qeshtjen e pronarit te kompanise pasi ne dokumentet e dosjes paraqitet si Afrim Sadiku ndersa ne dokumente zyrtare si ARBK dhe certifikaten mbi denimet penale me emrin Afrim Sadiki si dhe ne ARBK e dokumentet e dosjes adresa e biznesit ne Lipjan ndersa ne certifikaten e gjykates ne Prishtine prandaj AK eshte dashur te verifikoj a kemi te beje me 2 biznese te ndryshme apo si ka mundesi te ndodhin keto parregullesi, ne dokumentet zyrtare te leshuara nga institucione publike te republikes se Kosoves nuk ka mundesi nje person te kete ne dokumente te ndryshme te leshuara nga intitucionet publike emer apo mbiemer te ndryshem pasi te dhenat e cdo personi jane unike.

AK/Zyra e prokurimit ne dy kerkesat per ri-shqyrtim nuk ka arritur te beje shqyrtimin brenda afatit ligjor 3-5 dite por na eshte drejtuar me shkrese/njoftim per afat shtese konform nenit 108/a pika 6 dhe trajtimi i kerkeses per ri-shqyrtim heren e pare ka mare kohe 15dite ndersa heren e dyte 10dite, megjithate AK nuk ka trajtuar te gjitha pretendimet ankimore ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim vetem ne pika te shkurta eshte pergjigjur ne disa pretendime ankimore.

Mare parasysh faktet e lartecekura konstatojme se AK/komisioni vleresues ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem i cili nuk ploteson kriterin nr.3 lidhur me kapacitetin teknik&profesional dhe arsyet tjera te lartecekura.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik “INFINITT” SH.P.Kankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim Neni 1- Qellimi, Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, Neni 28- Specifikimet teknike, Neni 52.3- Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës, Neni 59- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi I tendereve, Neni 60- Kriteret per dhenie te kontrates, Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, Neni 72.3- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, Neni 10.1 I UOPP- Sqarimi I tendereve, Neni 19 I Rregullore per prokurim publik- Specifikimet teknike, Neni 40 i Rregullores per prokurim publik- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës. me datë 27.10.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë pas kërkit të sqarimeve shtesë me nenin 72, të LPP-sc, ka sjellë katalogun për pozicionet për të cilat pretendoni ju;

Pretendimi juaj është i pa bazuar sepse ju jo vctëm nuk keni plotësuar pjesën e formularit ku kërkohet të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga lideri(shënohet edhe njëherë cili është lideri) por edhe e keni fshirë këtë pjesë të formularit;

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 20.11.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1096/25, ndërsa me datë 26.11.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1096 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, dhe OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “INFINITT” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1096 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Furnizimi, montimi dhe servisimi i kondicionereve ne shkolla” me nr. të prokurimit: "632-25-6413-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, procedurë e hapur, lloji i kontratës furnizim, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, i cili OE ankuesin ka eliminuar me arsyetimin:

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

Arsyetim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju si Operator Ekonomik keni prezantuar. Deklaratën për themelimin e grupit, por ju mungon nënshkrimi dhe vula e përfaqësuesi i autorizuar. Andaj nuk i përmbushin kriteret e kërkuara në FDT.

Tutje, OE ankues në ankesë pretendon se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat, duke shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht dispozitat ligjore: 1,6,7,28,52.3,59,60,69,72.3, si dhe Rregulloren për Prokurim Publik nenet: 19, 40, Udhëzuesin për Prokurim Publik neni 10.1. për faktin se AK dy herë e vlerëson të rekomanduar të njëjtin OE.

Gjithashtu i njëjti ka parashtruar pretendime ankimore kundër arsyes së eliminimit të tyre i cili pretendon se marrëveshja posedon nënshkrimin dhe vulën, dhe duhet të merret e mirëqenë, gjithashtu në ankesë i njëjti pretendon se OE i rekomanduar ka sjellë katalog pas kërkesës për sqarim nga AK, dhe se nuk është katalog autentik nga prodhuesi Broshurë me foto nga prodhuesi, por është ngarkuar një katalog pa emër.

(Sqarim: të gjitha pretendimet e OE ankues i gjeni në pjesën lartë të raporti, përkatësisht pjesa “Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore”).

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, Autoriteti Kontraktues fillimisht me datë 10/09/2025 ka publikuar Vendimin B58 mbi rekomandimin e OE Astech SHPK, ndërsa OE ankuesin e eliminon me të njëjtën arsye të eliminimit. Në afat ligjor OE ankues parashtron kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, dhe ky i fundin aprovon kërkesën për rishqyrtim dhe aktivitetin e kthen në rivlerësim, me qëllim të sqarimit të katalogut nga OE i rekomanduar Astech SHPK. Dhe rrjedhimisht pas kërkesës për rishqyrtim AK me datë 13/10/2025 publikon Njoftimin B58 mbi rekomandimin e të njëjtit OE ndërsa OE ankues prap është i eliminuar për të njëjtën arsye të eliminimit : Marrëveshja e konzorciumit nuk posedon

nënshkrim dhe vulë të përfaqësuesit të autorizuar, pjesa e fundit është fshirë nga i njëjti”.

Dhe si e tillë, ekspertja shqyrtuese lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues sqaron se, Marrëveshja e konzorciumit konform nenit 44 Formularët Standard -paragrafi 2 dhe 3, të RRPP nr.002/2024 citat:

44.2 "Përdorimi i formularëve standard" do të thotë se dokumentet e prokurimit duhet të përmbajnë të paktën të gjitha informatat, kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përcaktuara në formularët standard si informacion të detyrueshëm, dhe në përgjithësi të jenë të qartë dhe të kuptueshme për OE të interesuar.

44.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët Ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header” apo kudo tjetër në dokumentet standarde.

Andaj si e tillë, në ofertën e OE ankues gjendet marrëveshja e konzorciumit e cila në pjesën ku kërkohet të përcaktohet përfaqësuesi i autorizuar, të njëjtit kanë fshirë pjesë e fundit të deklaratës, dhe sipas Rregullores për prokurim publik nr.002/2024 neni 44 par.3 formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde, prandaj edhe është eliminuar nga Autoriteti Kontraktues si i papërgjegjshëm. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.

Tutje, OE ankues përkundër që administrativisht nuk ka plotësuar kërkesat e AK-së në DT, i njëjti pretendon se OE i rekomanduar ka sjellë katalogun e cila nuk është i prodhuesit.

Ekspertja shqyrtuese lidhur me kërkesën e AK-së sqaron se, kërkesa në DT ka qenë:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog apo broshurë me fotografi nga prodhuesi, sipas specifikave të dosjes së tenderit.(katalogu duhet të jetë i njëjti për pajisjet e kërkuara).

Dëshmia e kërkuar:

Katalogu apo broshura me fotografi për produktet e ofruara se bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimin teknik dhe parametere nga prodhuesi

Megjithatë, AK në rivlerësim meqë OE ankues ka nënshkruar deklaratë mbi specifikat teknike të detyrueshme, lidhur me pozicionet e munguara në ofertë, ka kërkuar sqarime konform nenit 72 të LPP-së, duke kërkuar që të bashkëngjitet katalogu edhe për pozicionet e tjera të cilat mungojnë. Dhe duke qenë se AK në DT ka kërkuar Katalog pa specifikuar asgjë, APO broshurë me fotografi nga prodhuesi, atëherë OE i rekomanduar ka sjellë katalogun me specifikat si në parametere dhe me foto por jo nga prodhuesi. Si e tillë AK bazuar në raportin e rivlerësimit nga komisioni i rivlerësimit, vlerëson ofertën e OE të rekomanduar konform nenit 1; 6; 7; 56.3; 59.4; 72 të LPP-së, me qëllim që të realizoj aktivitetin e prokurimit.

Kurse sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim, ekspertja shqyrtuese pretendimin e gjenë të bazuar për faktin se AK konform nenit 61 par.3 të RRPP nr.002/2024, AK brenda 3 dite duhet të shqyrtoj kërkesën ose maksimum pas njoftimit

edhe 3 ditë të tjera plus, ndërsa AK ka publikuar vendimin mbi refuzimin në ditën e 7. Andaj pretendimi i OE ankues gjendet i qëndrueshëm.

Si përfundim, OE ankues posedon çmimin më të ulët ofertues, mirëpo administrativisht nuk plotëson kërkesat e DT-së, andaj si e tillë pretendimi i OE ankues nuk gjendet e qëndrueshëm.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “INFINITT” SH.P.K.. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “INFINITT” SH.P.K. , janë pjesërisht të bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, të paraqitura ndaj vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke

u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimit të ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik OE “INFINITT” SH.P.K duhet aprovet si pjeserisht e bazuar dhe mbet në fuqi, Vendimi i autoritetit kontraktues, i datës, 10.10.2025, për shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik fitues për aktivitetin e prokurimit. Rrjedhimisht Paneli shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Komuna Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, montimi dhe servisimi i kondicionerëve në shkollë” me numër të prokurimit; 632-25-6413-1-2-1. inicuar nga autoriteti kontraktues – Komuna Gjakovë.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/1096, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjeserishëm të ankesës të OE “INFINITT” SH.P.K., vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - " INFINITT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: